



Republika e Shqipërisë
Ministria e Arsimit dhe Sportit



Republika e Kosovës
Ministria e Arsimit, Shkencës,
Teknologjisë dhe Inovacionit

PAKETA E DOKUMENTEVE

MBI PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË KONKURSIT TË TEKSTIT TË VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE”

KOMISIONI I PËRBASHKËT PËR ORGANIZIMIN E KONKURSIT
PËR TEKSTIN E VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE”

Tiranë – Prishtinë 2022

- PËRMBAJTJA

- I. PROCEDURAT E KONKURSIT PËR TEKSTIN E VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE”**
- II. STANDARDET PËR TEKSTIN SHKOLLOR TË VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE”**
- III. KORNIZA E PËRBASHKËT E PROGRAMEVE TË GJUHËS SHQIPE PËR TEKSTIN E VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE”**
- IV. KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E RECENSUESVE**



I. PROCEDURAT E KONKURSIT
PËR TEKSTIN E VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE”



I. QËLLIMI

Qëllimi i këtij dokumenti është përcaktimi i procedurave dhe i kriterëve për zhvillimin e konkursit të tekstit shkollor të vetëm e të përbashkët “Abetare”, deri në shpalljen e tekstit fitues.

II. PËRSHKRIMI I TEKSTIT SHKOLLOR TË VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE”

1. Hartimi i Abetares bazohet:
 - a. Në kornizën e përbashkët të programeve të gjuhës shqipe për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare”;
 - b. Në standardet për tekstin shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”.
2. Teksti shkollor “Abetare” duhet të jetë:
 - a. Kopje fizike e tekstit.
 - b. Kopje fizike e fletores së punës.
 - c. Përmbajtja digjitale – pjesë e abetares për tekstin fitues.

III. PJESËMARRËSIT NË KONKURS

1. Pjesëmarrës në konkursin për tekstin shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare” janë dy subjekte juridike (një nga secili vend, jo të lidhur me njëri-tjetrin), të llojit “shtëpi botuese” të regjistruara/licencuara dhe të njohura si të tilla në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, sipas parashikimeve të mëposhtme:
 - a. Shtëpitë botuese të secilit prej vendeve aplikojnë në marrëveshje partneriteti me njëra-tjetrën duke autorizuar njërin prej tyre për ndjekjen e procedurave të konkurrimit (e quajtur në vijim “Subjekt aplikues”). Ato duhet të jenë të regjistruara/ licencuara sipas legjislacionit në fuqi të vendit përkatës.
 - b. Shtëpia botuese që bën aplikimin për pjesëmarrje në konkurs, quhet “Subjekt aplikues”, ndërsa shtëpia botuese që është në partneritet me subjektin aplikues, quhet “Subjekt bashkaplikant”.
 - c. Partneriteti midis subjektit aplikues dhe bashkaplikantit vërtetohet përmes një marrëveshjeje të lidhur mes tyre në një noteri publike. Shtëpitë botuese parashikojnë në marrëveshje të gjitha detyrimet në raport me gjithë ekipin realizues të tekstit dhe të drejtat e autorit.
 - d. Autorë të tekstit “Abetare” do të jenë autorë të përbashkët nga të dyja vendet. Autorët i rregullojnë marrëdhëniet me shtëpitë botuese nëpërmjet kontratave që lidhin me to. Nuk lejohet që një autor i përmbajtjes së abetares të konkurrojë me më shumë se një “Abetare”, në shtëpi botuese të ndryshme.
 - e. Subjekti aplikues dhe ai bashkaplikant duhet të përmbushin njëherazi kriteret ligjore të ushtrimit të veprimtarisë në përputhje me legjislacionin e vendit përkatës.



- f. Mospërmbushja e kriterëve ligjore nga subjekti aplikues dhe/ose bashkaplikanti sjell skualifikimin në konkurs.
 - g. Nëse subjekti aplikues shpallet fitues në konkurs, subjekti bashkaplikant do të bëhet përfitues së bashku me subjektin aplikues.
- 2. Shtëpitë botuese duhet të kontraktojnë autorë të fushës.
 - 3. Shtëpitë botuese dhe përfaqësuesit ligjorë të tyre nuk duhet të jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, si dhe ndaj tyre të mos jetë nisur një hetim penal.
 - 4. Shtëpitë botuese duhet të dokumentojnë përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore për shlyerjen e tatimeve apo taksave.
 - 5. Dy subjektet (aplikant/bashkaplikant) kanë të drejtë të konkurrojnë vetëm me një alternativë.

AFATET E KONKURSIT

- 1. Komisioni i përbashkët për organizimin e konkursit për tekstin shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare” në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës (në vijim Komisioni) vendos shpalljen e konkursit për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare”.
- 2. Ministritë përgjegjëse për arsimin në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës publikojnë thirrjen për aplikim për konkursin për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare” në faqet zyrtare përkatëse.
- 3. Thirrja për konkurs përmban:
 - a. Titullin e tekstit shkollor për të cilin zhvillohet konkursi.
 - b. Datat e dorëzimit të dokumentacionit dhe kryerjes së aplikimit nga ana e subjektit aplikues.
 - c. Vendin e dorëzimit të dokumentacionit nga ana e subjektit aplikues.
- 4. Afati i aplikimit do të jetë 2 (ditë) ditë pune për secilin vend (2 ditë pune në Prishtinë dhe 2 ditë pune në Tiranë).
- 5. Pranimi i dokumentacionit bëhet nga Komisioni.
- 6. Në ditën e aplikimit, subjekti aplikues depoziton dokumentacionin ligjor dhe teknik.
- 7. Anëtarët e Komisionit dhe sekretaria teknike në funksion të tij duhet të nënshkruajnë deklaratën për pajtueshmërinë me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave, sipas shtojcës 7 bashkëlidhur kësaj pakete dokumentesh.



IV. DOKUMENTACIONI LIGJOR I NEVOJSHËM PËR KONKURS

1. Subjekti aplikues duhet të paraqesë dokumentacion ligjor të mëposhtëm:
 - a. Marrëveshjen e partneritetit me bashkaplikantin lidhur në një noteri publike.
 - b. Dokumentin për regjistrimin si person juridik me të drejtë ushtrimi aktiviteti si botues.
 - c. Certifikatën e regjistrimit në organet tatimore për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.
 - d. Dokumentin që vërteton se shtëpitë botuese dhe përfaqësuesit ligjorë të tyre nuk rezultojnë të dënuar me vendim të formës së prerë.
 - e. Vërtetimin nga strukturat e tatimeve dhe taksave për shlyerjen e detyrimeve përkatëse.
2. Subjekti aplikues paraqet dokumentacionin e parashikuar në pikën 1 të këtij kreu, edhe për bashkaplikantin.
3. Dokumentet e përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu të jenë të lëshuara nga institucionet e vendeve përkatëse, jo më vonë se tri muaj nga data e aplikimit të subjektit aplikues.
4. Dokumentacioni i mësipërm shqyrtohet nga Komisioni, i cili shënohet në procesverbal, ku nënshkruajnë të gjithë anëtarët e Komisionit.
5. Mungesa ose pasaktësia, qoftë dhe e njërit prej dokumentacioneve ligjore, sjell mospranimin në vlerësim të subjektit aplikues.

V. DOKUMENTACIONI TEKNIK I NEVOJSHËM PËR KONKURS

1. Subjekti aplikues duhet të paraqesë dokumentacion teknik të mëposhtëm:
 - a. Deklaratën e botuesit për pajtueshmërinë me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur kësaj pakete dokumentesh.
 - b. Deklaratën për të drejtën e botimit mbi origjinalitetin e tekstit shkollor në tërësi dhe të pjesëve të veçanta të tij, si dhe kopje të akteve ose të marrëveshjeve që mund të jenë bërë për aplikimin, për marrjen e lejes ose blerjen e elementeve të veçanta të së drejtës së autorit nga të tretët, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur kësaj pakete dokumentesh.
 - c. Deklaratën për autorësinë e tekstit, sipas shtojcës 3 bashkëlidhur kësaj pakete dokumentesh.
 - d. Deklaratën për çmimin e shitjes të tekstit shkollor, sipas shtojcës 4 bashkëlidhur kësaj pakete dokumentesh.
 - e. Të dhëna për grupin hartues/realizues të tekstit shkollor, sipas shtojcës 5 bashkëlidhur kësaj pakete dokumentesh.
 - f. Vetëdeklarimin për përmbushjen e kriterëve teknike të tekstit shkollor, sipas shtojcës bashkëlidhur 6 bashkëlidhur kësaj pakete dokumentesh.
2. Dokumentacioni teknik i mësipërm dorëzohet për tekstin shkollor dhe duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar.



3. Dokumentacioni teknik i mësipërm, për tekstin shkollor duhet të dorëzohet në zarf të bardhë të formatit A4, të mbyllur dhe të dyllosur, pa shenja të jashtme dalluese që mund të zbulojnë përkatësinë e zarfit.
4. Dokumentacioni teknik shqyrtohet nga Komisioni dhe dokumentohet me procesverbal, pas përfundimit të vlerësimit dhe shpalljes së renditjes paraprake.
5. Mungesa ose pasaktësia, qoftë dhe e njërit prej dokumentacioneve teknike, sjell skualifikimin nga vlerësimi i subjektit aplikues.
6. Në rast se dokumentacioni ligjor dhe teknik i subjektit aplikues është i plotë dhe në përmbushje të parashikimeve të mësipërme të pikës 5, Komisioni shpall rezultatin e vlerësimit të tekstit shkollor “Abetare”.

VI. PRANIMI I TEKSTEVE SHKOLLORE NË KONKURS

1. Kriteret për pranimin e teksteve shkollore në konkurs janë si vijon:
 - a. Subjekti të dorëzojë për konkurs 12 kopje fizike të titullit të tekstit shkollor dhe fletores së punës, pjesë e ndarë nga teksti i Abetares.
 - b. Çdo kopje e tekstit shkollor dhe e fletores së punës të jetë e radhitur, e faqosur dhe e shtypur me letrën dhe në formatin siç parashikohet të dalë nga shtypi.
 - c. Çdo kopje të jetë e lidhur me vrima e me kapëse plastike me ngjyrë të zezë; të mos ketë kopertinë e frontespice; faqet të mos përmbajnë elemente që mund të identifikojnë përkatësinë e tekstit shkollor.
 - d. Asnjë prej kopjeve të tekstit shkollor (dhe fletores) të paraqitura për konkurs të mos përmbajë shenjat e zakonshme të identifikimit që i ka teksti kur është i gatshëm për përdorim, si: autorët, emrin apo logon e shtëpisë botuese etj.
 - e. Në çdo kopje të tekstit shkollor që do të dorëzohet, titulli i tij të shkruhet sipas emërimit të përcaktuar nga komisioni (ABETARE). Ai të shkruhet me ngjyrë të zezë, me germa të mëdha shtypi, tip “Bookman Old Style”, bold, me madhësi 36-she. Në rast moszbatimi të kësaj kërkesë, teksti shkollor nuk pranohet për konkurs.
 - f. Numrat rendorë të faqeve të jenë të shkruar në anën e djathtë, në faqet teke, dhe në anën e majtë, në faqet çift, poshtë çdo faqeje, në tipin e germave të vogla “Bookman OldStyle”, me madhësi 12-she, me ngjyrë të zezë, jo bold.
2. Kopjet e tekstit shkollor dhe fletores së punës të paraqiten pa kopertina dhe frontespice; si kopertinë, në formatin e bllokut, t’u ngjitet letër e bardhë 80 g/ m², ku titulli të shkruhet sipas përcaktimit të bërë në germën e, të pikës 1, më lart.
3. Në rast pranimi të dokumentacionit ligjor, dokumentacionit të tekstit shkollor për konkurs, komisioni i jep subjektit aplikues një nga dy kopjet e formularit për marrjen në dorëzim. Dokumentacioni ligjor, dokumentacioni i tekstit shkollor, në asnjë rast dhe për asnjë arsye, nuk i kthehen subjektit aplikues.



VII. KRITERET MBI PËRMBAJTJEN DIGJITALE

1. Pas përfundimit të konkursit dhe vlerësimit të tekstit, shpalljes së fituesit, shtëpitë botuese fituese duhet të paraqesin në Komision dhe përmbajtjen digjitale të tekstit fitues.
2. Përmbajtja digjitale duhet të jetë në përputhje me tekstin e Abetares dhe me standardet për tekstin shkollor të përbashkët të Abetares.
3. Përmbajtja digjitale duhet të ofrojë 4 (katër) qëllimet kryesore:
 - a. Qasjen për t'u përdorur lehtësisht nga të gjithë nxënësit.
 - b. Lehtësinë me të cilën përmbajtja digjitale mbartet nga një hardware, ose mjedis software, në tjetrin.
 - c. Lehtësinë me të cilën përdoruesit mund të punojnë me të dhe të arrijnë rezultatet e përcaktuara në kurrikul.
 - d. Mundësinë që përmbajtja digjitale të jetë e përshtatshme për t'u përdorur në mënyrë të pavarur dhe të përshtatet në kontekste të tjera.
4. Kriteret që duhet të plotësojë përmbajtja digjitale mësimore, janë:
 - a. Të integrojë funksionet: mësimdhënie, të nxënë dhe ndërveprim mësues-nxënë.
 - b. Të ketë fleksibilitet për çdo format përdorimi në grup ose individualisht, si në mësimin në klasë ashtu dhe në distancë.
 - c. Të funksionojë 100% në çdo pajisje elektronike me sistem operativ Android, Windows dhe IOS, në të gjithë përmbajtjen digjitale.
 - d. Të mundësojë përditësimin teknik dhe përmbajtjesor, pa penguar ecurinë funksionale të përdorimit.
 - e. Të mundësojë lehtësisht qasje (akses), në mënyrë që të sigurojë cilësinë e mësimdhënies.
5. Përmbajtja digjitale duhet të jetë e ndërveprueshme dhe të sigurojë:
 - a. Funksionalitetin e videove, audiove, animacioneve ose materialeve të tjera shtesë, edhe në rastet kur përdoruesi nuk ka lidhje në internet.
 - b. Qasje të lehtë të përdoruesit të fundit (nxënë dhe mësues, prindër etj.).
6. Përmbajtja digjitale nuk duhet të jetë e kufizuar në hyperlinks, navigacion, elementet dhe modifikimet e përdoruesit.
7. Komponentët e përmbajtjes mund të përsëriten apo të përditësohen në tërësinë e tyre ose në pjesë të veçanta, si p.sh.: testimet, simulimet, tema/modulet, diskutimet etj.
8. Përmbajtja mësimore të organizohet në dosje/file të veçanta që korrespondojnë me tematikat dhe rezultatet e të nxënit sipas tekstit shkollor fizik.
9. Përmbajtja digjitale të shoqërohet me udhëzues për përdorimin nga mësuesit që do të punojnë me këto përmbajtje.



VIII. VLERËSIMI I TEKSTEVE SHKOLLORE NË KONKURS

1. Vlerësimi i teksteve shkollore në konkurs realizohet si më poshtë:
 - a. Vlerësimi i tekstit shkollor në konkurs bëhet nga 10 recensues, me numër të barabartë nga të dyja vendet, prej të cilëve:
 - dy specialistë/pedagogë të gjuhës shqipe,
 - dy specialistë/pedagogë të letërsisë,
 - katër mësues të arsimit fillor.
 - dy redaktorë gjuhësorë.
 - b. Teksti shkollor vlerësohet nëse është në përputhje me standardet e tekstit shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”.
 - c. Recensuesit vlerësojnë në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.
 - d. Përveç pikëzimit, recensuesit shkruajnë edhe një raport të argumentuar për vlerësimin e bërë.
 - e. Recensuesit nënshkruajnë deklaratën për pajtueshmërinë me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave, sipas shtojcës 8 bashkëlidhur kësaj pakete.
2. Komisioni, mbi bazën e vlerësimeve të recensuesve:
 - a. Përlllogarit pikët e grumbulluara për çdo tekst në konkurs, duke nxjerrë vlerën mesatare të pikëve sipas standardeve për secilin tekst në dorëshkrim.
 - b. Shpall listën paraprake të teksteve në konkurs që kanë plotësuar vlerën mesatare të standardeve dhe i rendit sipas pikëve.
3. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të përmbajtjes së teksteve në konkurs, Komisioni, në prani të subjekteve aplikuese, bën hapjen e zarfeve ku ndodhen edhe formularët përkatës të çmimeve të shitjes të propozuara për njësi, nga çdo subjekt aplikues. Një kopje e procesverbalit të hapjes vihet në dispozicion të subjekteve aplikuese.
4. Komisioni përcakton çmimin mesatar aritmetik (çmimin tavan), i cili përlllogaritet si shumatore e çmimeve të propozuara nga të gjitha subjektet aplikuese, pjesëtuar me numrin e teksteve shkollore në konkurs të dorëzuara. Nëse çmimi mestar e tejkalon çmimin mesatar të tekstit analog të Abetares së përbashkët Shqipëri-Kosovë, atëherë do të aplikohet çmimi i abetares ekzistuese me një marzh që do të përcaktohet nga ekspertët e fushës me një analizë të kostos. Çmimi tavan të aplikohet për ato tekste shkollore në konkurs, për të cilat çmimi i propozuar nga subjekti aplikues e tejkalon çmimin tavan, ndërsa për tekstet e ofruara me çmim poshtë çmimit tavan, si çmim i shitjes të vendoset ai i propozuar nga subjekti aplikues. Në të njëjtën mënyrë do të llogaritet dhe çmimi i fletores së punës. Çmimi do të vendoset në kopertinë në euro dhe në lekë.
5. Në rast se dy tekste shkollore në konkurs kanë pikë të barabarta, përzgjidhet teksti që ka pikë më shumë në standardin lëndor.



IX. SHPALLJA PËRFUNDIMTARE E TEKSTIT SHKOLLOR FITUES

1. Komisioni u dërgon për miratim ministrave përgjegjës të të dyja vendeve listën e renditjes së teksteve “Abetare”, shoqëruar me fletoren e punës.
2. Vendimin për miratimin e tekstit shkollor fitues e marrin ministrat përgjegjës të të dyja vendeve.
3. Teksti shkollor në konkurs i renditur i pari është teksti që do të përdoret si Abetare në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës. Në rast se shtëpia botuese e këtij teksti nuk i përmbush detyrimet e botimit, të kërkuara nga ministratë përgjegjëse, për shpërndarjen e teksteve shkollore në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Shqipërisë, atëherë do të përdoret teksti i renditur i dyti, e kështu me radhë në vijim.

X. ANKIMI PËR VENDIMIN/URDHRIN E MINISTRAVE PËRGJEGJËS

1. Çdo subjekt aplikues që është i pakënaqur me aktin administrativ të ministrave përgjegjëse të të dy vendeve, ka fillimisht të drejtën e ankimit përmes rrugës administrative, sipas afateve e procedurave si më poshtë:
 - a. Subjekti aplikues ka të drejtën e ankimit administrativ brenda 3 (tri) ditëve-punë nga marrja në dijeni, por jo më shumë se 15 ditë-punë nga marrja e vendimit. Ankimi administrativ paraqitet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit aplikues.
 - b. Ankimi administrativ depozitohet me shkrim dhe në të përshkruhet interesi i ligjshëm lidhur me procesin e zhvillimit të konkursit.
 - c. Ankimi administrativ bëhet në vendin ku është bërë aplikimi. Në Republikën e Kosovës, ankimi administrativ paraqitet në Komisionin e Ankesave, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ndërsa në Republikën e Shqipërisë ankimi administrativ paraqitet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
 - d. Komisionet e shqyrtimit të ankimit administrativ duhet t’i shqyrtojnë ankimet brenda 30 ditëve.
2. Ndaj vendimit administrativ të komisioneve përkatëse, subjekti aplikues i pakënaqur ka të drejtën e parashtrimit të padisë në gjykatën kompetente të vendit përkatës.



XI. DETYRIMET E SUBJEKTEVE APLIKUESE

1. Subjekti aplikues merr përsipër dhe mban përgjegjësi për marrëdhëniet e tij me autorët e teksteve, për përgatitjen për shtyp të origjinalit të tekstit dhe të përmbajtjes digjitale, për zbatimin e kërkesë/porosive për tekste nga ministritë përgjegjëse të të dyja vendeve (Shqipëri dhe Kosovë) për porositjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore.
2. Subjekti aplikues, në kopertinën e çdo teksti shkollor, shënon të gjitha elementet sipas legjislacionit në fuqi të të dyja vendeve (Shqipëri dhe Kosovë).

XII. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Dokumentacioni ligjor lidhur me procesin e konkursit, miratimit, porosities, shpërndarjes së tekstit shkollor “Abetare” (aktet, korniza e përbashkët e programeve, standardet e tekstit të Abetares etj.), si dhe çdo material tjetër shpjegues për të interesuarit, të publikohen në faqet zyrtare të ministrive përgjegjëse të të dy vendeve për zbatimin e kësaj pakete dokumentesh.
2. Dokumentacioni i administruar nga sekretaria teknike do të arkivohet në ministritë përkatëse atje ku janë bërë aplikimet, pas shpalljes së tekstit fitues sipas legjislacionit në fuqi të secilit vend.



SHTOJCA 1

DEKLARATË PËR PAJTUESHMËRINË ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Deklaroj se asnjë prej anëtarëve të ekipit hartues të tekstit shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”, të përfshirë në shtojcat 3 dhe 5, dorëzuar për konkurs në Komisionin e përbashkët për organizimin e konkursit për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare”, nuk ka interesa familjare ose financiare me ndonjë anëtar të tij ose të sekretarisë teknike të këtij komisioni.

Deklaroj po ashtu se unë, nënshkruesi i kësaj deklarate, nuk jam i lidhur me interesa familjare ose financiare me anëtarë të komisionit dhe të sekretarisë së përmendur më lart.

_____, më _____.2022

Për botuesin

(emri zyrtar i subjektit aplikues)

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)



SHTOJCA 2

DEKLARATA PËR TË DREJTËN E BOTIMIT

Deklaroj “Të drejtën e botimit” të tekstit shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”, dorëzuar për vlerësim në Komisionin e përbashkët për organizimin e konkursit për tekstin e mësipërm.

Nr.	Pjesa e tekstit ose teksti në tërësi	Zotëruesi	Burimi

_____, më _____.____.2022

Për botuesin

(emri zyrtar i subjektit)

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

Shënim për plotësimin e formularit

Si pjesë e tekstit të Abetares, për efekt të burimit të së drejtës së botimit mund të përfshihen edhe ilustrime, ide ose punë editoriale. Zotërimi i kësaj të drejte nga subjekti përkatës duhet të dëshmohet në kontratën përkatëse të lidhur mes autorit/ëve dhe botuesit ose me dokumente të blerjes apo dhurimit të kësaj të drejte nga të tretë, kopje të noterizuara të të cilave i bashkëlidhen kësaj deklaratë. Në rastet kur e drejta e botimit është fryt i punës origjinale të vetë subjektit, në kolonën e tretë për burimin e të drejtës së botimit shënohet “Punë origjinale”. Në kolonën e burimit të së drejtës së botimit shënohet, sipas rastit: “Origjinale” ose “Nga të tretë” (shënohet në kllapa pala e tretë dhe përfshihet dokumenti i blerjes apo dhurimit).



SHTOJCA 3

DEKLARATA PËR AUTORËSINË E TEKSTIT

Deklaroj se autori/ët e tekstit shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”, dorëzuar për konkurs në Komisionin e përbashkët për organizimin e konkursit për tekstin e mësipërm, janë:

Emri dhe mbiemri	Pjesa e tekstit (kapitujt ose thjesht bashkautorësi)

_____, më _____.____.2022

Për botuesin

(emri zyrtar i subjektit)

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)



SHTOJCA 4

DEKLARATA PËR ÇMIMIN E SHITJES PËR NJËSI TË TEKSTIT SHKOLLOR TË VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE” DHE FLETORES SË PUNËS

Deklaroj se çmimi i shitjes për njësi të tekstit shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare” dhe fletores së punës, dorëzuar për vlerësim në Komisionin e përbashkët për organizimin e konkursit për tekstin e mësipërm, është:

_____, _____)lekë/euro.
(me shifra) (me shkrim)

_____, më _____.____.2022

Për botuesin

(emri zyrtar i subjektit)

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)



SHTOJCA 5

TË DHËNA PËR EKIPIN HARTUES/REALIZUES TË TEKSTIT SHKOLLOR TË VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE”

Autorësia	Po	Jo
Autor i vetëm, pedagog/profesor universiteti/me gradë shkencore		
Autor i vetëm, mësues/mësimdhënës		
Dy ose më shumë pedagogë/profesorë universiteti/me gradë shkencore		
Dy ose më shumë mësues/mësimdhënës		
Pedagog/profesor universiteti/me gradë shkencore dhe mësues/mësimdhënës		
Më shumë se dy pedagogë/profesorë universiteti/me gradë shkencore dhe mësues/mësimdhënës		

Përvoja pedagogjike:

- Mësues/mësimdhënës _____vjet

- Pedagog _____vjet

_____, më _____.____.2022

Shënim për plotësimin e formularit.

Të dhënat përkatëse të pasqyrohen brenda kutisë duke përdorur simbolin “X”



1. Redaktorët shkencorë:

a. Redaktori i parë _____

Institucione arsimore të kryera:	I punësuar në
	Punëdhënësi:

b. Redaktori i dytë (në qoftë se ka) _____

Institucione arsimore të kryera:	I punësuar në
	Punëdhënësi:

2. Redaktorët gjuhësorë:

a. Redaktori i parë _____

Institucione arsimore të kryera:	I punësuar në
	Punëdhënësi:

b. Redaktori i dytë (në qoftë se ka) _____

Institucione arsimore të kryera:	I punësuar në
	Punëdhënësi:

_____, më __. __. 2022

Shënim.

Deklarata plotësohet nga botuesi për çdo anëtar të ekipit realizues për tekstin shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”.

Për botuesin

(emri zyrtar i subjektit)

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)



SHTOJCA 6

DEKLARIMI PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TEKNIKE TË TEKSTIT SHKOLLOR TË VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE”

Teksti i abetares duhet të përmbushë kriteret teknike të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

NR	ELEMENTET E TEKSTIT SHKOLLOR	KRITERET	PO	JO
1.	Organizimi i përmbajtjes së tekstit shkollor	Përmbajtja e tekstit shkollor paraqitet në një vëllim		
2.	Formati i prerë i tekstit shkollor	207 mm gjerësi x 277 mm gjatësi		
3.	Madhësia e shkronjave/karaktereve	Shkronja me font size 14-18		
4.	Hapësira mes rreshtave	Hapësira mes rreshtave: 120% e shkronjave		
5.	Lloji i letrës për bllokun e librit dhe të fletores së punës	Asnjë lloj letre me lustër		
		Opaciteti 80 për qind (ISO 2471)		
		Shkëlqimi 83 për qind (ISO 2470)		
		Pesha e letrës së librit 90 gsm		
		Pesha e letrës së fletores së punës 80 gsm		
6.	Lloji i letrës për kopertinën	Kopertina e Abetares të jetë me kartonçinë të tipit “matt” ose “ simcot” me peshë jo më pak se 350g/m2		
		Kopertina e Fletores së Punës të jetë me kartonçinë të tipit “matt” ose “ simcot” me peshë 250-260 g/m2		
7.	Ngjyrat për bllokun e librit / fletores së punës	Libri i nxënësit 4 ngjyra		
		Fletore pune e detyrueshme 4 ngjyra		
		Kopertinat 4 ngjyra		
8.	Lloji i lidhjes Abetare/Fletore Pune	Abetare fashikujt të qepur me penjë/ Fletore pune me ngjitje		
		Bashkimi i bllokut me kapakun me ngjitje me hotmelt		
9.	Elemente të detyrueshme të kopertinave	ISBN-ja		
		Barkod-i		
		Çmimi në euro dhe lekë		
		Logo-ja e botuesit		
		Emrat e autorëve dhe të ekipit realizues		



SHTOJCA 7

DEKLARATË E ANËTARIT TË KOMISIONIT TË PËRBASHKËT PËR ORGANIZIMIN E KONKURSIT PËR TEKSTIN SHKOLLOR TË VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE” DHE TË SEKRETARISË TEKNIKE TË TIJ PËR PAJTIMIN ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Unë, i nënshkruari _____, anëtar/sekretar i Komisionit të përbashkët për organizimin e konkursit për tekstin shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”, deklaroj nën përgjegjësinë dhe vullnetin tim të plotë se nuk kam konflikt interesi të asnjë lloji për të marrë pjesë në konkurs për tekstin shkollor “Abetare”.

Në mënyrë të veçantë pohoj, se:

- Nuk jam pjesë e ekipit realizues në asnjë prej teksteve shkollore “Abetare”, të dorëzuara në komisionin e përbashkët për organizimin e konkursit për tekstin shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”.
- Nuk kam lidhje familjare dhe financiare me pronarë të shtëpive botuese që marrin pjesë në procesin e prodhimit të tekstit shkollor “Abetare”, të dorëzuar në Komisionin e përbashkët për organizimin e konkursit për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare”.

DEKLARUESI

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

_____, më _____.2022



SHTOJCA 8

DEKLARATË E RECENSUESIT PËR PAJTIMIN ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Unë i/e nënshkruari/a _____, me të dhënat e mëposhtme, deklaroj nën përgjegjësinë dhe vullnetin tim të plotë se nuk kam konflikt interesi të asnjë lloji për të marrë pjesë në vlerësimin e tekstit shkollor “Abetare”.

Në mënyrë të veçantë pohoj, se:

- Nuk jam pjesë e ekipit realizues në asnjë prej teksteve shkollore “Abetare”, të dorëzuara në komisionin e përbashkët për organizimin e konkursit për tekstin shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”.
- Nuk kam lidhje familjare dhe financiare me pronarë të shtëpive botuese që marrin pjesë në procesin e prodhimit të tekstit shkollor “Abetare”, të dorëzuar në Komisionin e përbashkët për organizimin e konkursit për tekstin shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”.

DEKLARUESI

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Telefon/celular: _____

e-mail: _____

Rruga _____ Lagja _____

Bashkia/komuna _____

Emri i bankës _____ IBAN _____

SWIFT CODE _____ Nr. i llogarisë _____

_____, më _____.2022



II. STANDARDET PËR TEKSTIN SHKOLLOR TË VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE”



Dokumenti “Standardet për tekstin shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”” përbëhet nga dy pjesë: pjesa e standardeve të përgjithshme dhe pjesa e standardit plotësues lëndor. Pjesa e parë e standardeve është pothuajse e njëjtë me standardet e të gjitha teksteve shkollore, për shkak se përmban aspekte të përgjithshme dhe të vlefshme për të gjitha tekstet shkollore (përfshirë edhe Abetaren), ndërsa standardi plotësues lëndor ka tregues që janë specifike për Abetaren. Dokumenti përbëhet prej 15 standardeve.

Qëllimi dhe funksionet e standardeve

Ky dokument u drejtohet specialistëve të arsimit, mësuesve, shtëpive botuese, autorëve të teksteve shkollore, recensuesve dhe komisioneve për miratimin e tekstit shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”.

Qëllimi i këtyre standardeve është që ato të përdoren si udhëzues dhe instrument për hartimin dhe vlerësimin e tekstit shkollor “Abetare” duke u bazuar në tregues të matshëm.

Standardet janë në funksion të përmbushjes së qëllimeve dhe kërkesave të programit mësimor të përbashkët për Abetaren.

STANDARDET, TREGUESIT DHE LLOGARITJA E TYRE

Standardet

Standardet për tekstin shkollor “Abetare”, janë:

1. Standardet e përgjithshme:
 - a. Përputhshmëria me kurrikulën, formatimi, paraqitja.
 - b. Aspekte shkencore dhe didaktike.
 - c. Aspekte pedagogjike;
 - d. Aspekte të praktikës mësimore.
2. Standardi plotësues lëndor:
 - a. Standardi për tekstin shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”.



TREGUESIT E STANDARDEVE DHE LLOGARITJA E TYRE

Për secilin standard janë përcaktuar treguesit, përmes të cilëve mund të gjykohet se deri në ç'masë është përmbushur ai (standardi). Masa e përmbushjes së treguesve vlerësohet me numrat nga 0 deri në 4, të cilët kanë këtë domethënie (vlerë):

0 = Nuk përmbushen - kërkesat e treguesit në fjalë nuk janë respektuar aspak në tekstin shkollor.

1 = Përmbushen pjesërisht - disa nga kërkesat e treguesit mund të jenë mbajtur parasysh, por teksti shkollor nuk i përmbush sa e si duhet ato.

2 = Përmbushen mjaftueshëm - vetëm disa prej kërkesave të treguesit përkatës përmbushen në tekstin shkollor, por ende jo mirë.

3 = Përmbushen mirë - kërkesat e treguesit përkatës janë përmbushur mirë në tekstin shkollor, por disa përmirësime janë të mundshme.

4 = Përmbushen shumë mirë - kërkesat e treguesit përkatës janë përmbushur shumë mirë në tekstin shkollor.

Vlera e secilit standard mund të llogaritet përmes formulës si në shembullin e tabelës.

Shembull

Standardi 1: **Përputhshmëria me kurrikulën**

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
1.1.	Teksti shkollor përputhet me parimet dhe me qëllimet e Kornizës së kurrikulës së Republikës së Kosovës dhe të Kornizës kurrikulare të arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë.				X	
1.2.	Teksti shkollor përputhet me kornizën e përbashkët të programeve të gjuhës shqipe për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare”.			X		
1.3.	Teksti shkollor është në koherencë me tekstet e klasave pasuese dhe ruan vazhdimësinë e programit mësimor të lëndës “Gjuhë shqipe”.					X
Shuma e vlerave të tregueseve $(1.1 + 1.2 + 1.3) = 3 + 2 + 4 = 9$ Vlera e standardit $1 = 9 : 3 = 3$ (I përmbushur mirë)						

Llogaritja e vlerës së tekstit shkollor në tërësi bëhet duke gjetur mesataren aritmetike të vlerave të të gjitha standardeve. (shihni formularin përmbledhës/vlera e tekstit, në fund të materialit/dokumentit).



STANDARDET E PËRGJITHSHME

I. PËRPUTHSHMËRIA ME KURRIKULËN, FORMATIMI, PARAQITJA (STANDARDET 1-3)

STANDARDI 1: PËRPUTHSHMËRIA ME KURRIKULËN

Synimi: Teksti shkollor të përputhet me parimet dhe me qëllimet e Kornizës së kurrikulës së Republikës së Kosovës dhe të Kornizës kurrikulare të arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë, si dhe me programet mësimore të gjuhës shqipe.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
1.1.	Teksti shkollor përputhet me parimet dhe me qëllimet e Kornizës së kurrikulës së Republikës së Kosovës dhe të Kornizës kurrikulare të arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë.					
1.2.	Teksti shkollor përputhet me kornizën e përbashkët të programeve të gjuhës shqipe për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare”.					
1.3.	Teksti shkollor është në koherencë me tekstet e klasave pasuese dhe me programet mësimore të lëndës “Gjuhë shqipe” .					

Vlera e standardit 1 = $\{[1.1 + 1.3] : 3\} =$



STANDARDI 2: PARAQITJA DHE QARTËSIA

Synimi: Teksti shkollor të ketë faqosje të pëlqyeshme dhe strukturë të qartë, dhe të ndihmojë orientimin e shpejtë të nxënësve në të. Gjithashtu, teksti shkollor të respektojë të drejtën e autorit.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
2.1.	Teksti shkollor ka paraqitje të jashtme dhe të brendshme, aktuale dhe tërheqëse (sa u takon kopertinës, kompozimit të faqes, koherencës së konceptimit grafik me faqosjen, madhësisë së germave dhe largësisë mes rreshtave).					
2.2.	Teksti shkollor në tërësi ka strukturë të qartë që lejon orientim të shpejtë dhe të lehtë (p.sh., përmes pasqyrës së përmbajtjes së tekstit, përmes simboleve orientuese etj.).					
2.3.	Teksti shkollor mundëson orientimin në secilën faqe në mënyrë të përshtatshme për moshën e nxënësve. Elementet dhe mjetet grafike (përfshirë simbolet dhe piktogramet që ndihmojnë në orientim), si dhe ilustrimet përdoren në mënyrën e duhur.					
2.4.	Burimet e teksteve që merren nga veprat e tjera, janë dhënë me korrektësi.					

Vlera e standardit 2 = $\{[2.1 + - + 2.4] : 4\} =$



STANDARDI 3: ILUSTRIMET

Synimi: Ilustrimet (fotografitë, vizatimet, pikturat, piktogramet, diagramet, tabelat, grafikët, komentet e shkurtra shpjeguese etj.) të jenë të kuptueshme, krijuese dhe plotësuese dhe të nxitin vetëveprimin e nxënësit.

Cilësia e ilustrimeve të jetë e lartë nga pikëpamja estetike, dokumentare dhe shpjeguese.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
3.1.	Ilustrimet (fotografitë, vizatimet, pikturat, piktogramet, hartat, diagramet, tabelat, grafikët etj.) plotësojnë shkrimet e tekstit.					
3.2.	Ilustrimet kanë cilësi të lartë nga pikëpamja estetike, dokumentare apo shpjeguese.					
3.3.	Ilustrimet janë të kuptueshme, të larmishme dhe përputhen me përmbajtjen mësimore.					
3.4.	Ilustrimet janë të mjaftueshme për njësitë/temat mësimore.					

Vlera e standardit 3 = $\{[3.1 + \dots + 3.4] : 4\} =$



II. ASPEKTET SHKENCORE DHE DIDAKTIKE

(Standardet 4-8)

STANDARDI 4: CILËSIA, RËNDËSIA DHE AKTUALITETI NË PIKËPAMJE PËRMBAJTËSORE DHE SHKENCORE

Synimi: Përmbajtja shkencore, shtjellimi didaktik dhe metodik i përmbajtjeve mësimore (përkatësisht, kombinimet shkrime–ilustrime) dhe situatat/përvojat e paraqitura në tekstin shkollor të jenë të sakta, aktuale dhe të rëndësishme për njësitë/temat e trajtuara.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
4.1.	Shkrimet në tekstin shkollor kanë përmbajtje me saktësi shkencore, vlerë arsimore dhe edukative dhe janë në përputhje me kërkesat e shoqërisë së sotme dhe të nesërme.					
4.2.	Nga pikëpamja shkencore, shkrimet e zgjedhura në tekstin shkollor janë korrekte, të rëndësishme dhe të përshtatshme për temat e trajtuara.					
4.3.	Shkrimet në tekstin shkollor, metodologjia e trajtimit të tyre, si dhe tipat e ushtrimeve, detyrave dhe pyetjeve të zgjedhura janë në përputhje me arritjet në shkencë dhe në didaktikë.					
4.4.	Teksti shkollor kontribuon në arritjen e të rezultateve të të nxëniet, të përcaktuara në programin mësimor për Abetaren.					

Vlera e standardit 4 = $\{[4.1 + - + 4.4] : 4\} =$



STANDARDI 5: PËRSHTATJA ME MOSHËN E NXËNËSVE

Synimi: Përmbajtjet e tekstit shkollor, pamja, niveli i vështirësisë, faqosja dhe elemente të tjera të ngjashme me këto të përshtaten me moshën e nxënësve, për të cilët ai është konceptuar. Teksti shkollor të jetë i kuptueshëm, i vlefshëm nga ana mësimore - edukative dhe tërheqës për grup-moshën në fjalë.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
5.1.	Përmbajtjet mësimore të trajtuara në tekstin shkollor përputhen mirë me mundësitë njohëse dhe përvetësuese të grup-moshës në fjalë.					
5.2.	Përmbajtjet në tekstin shkollor (kombinimet shkrim-ilustrim) janë në përputhje me përvojat, kërkesat, rrethanat e jetës së grup-moshës përkatëse të nxënësve, duke marrë parasysh heterogjenitetin e përvojave dhe interesave të tyre.					
5.3.	Elementet grafike të tekstit shkollor (ilustrimet, fotografitë, grafikët, hartat etj.) përputhen me karakteristikat e grup-moshës së nxënësve dhe janë të kapshme e tërheqëse për ata.					
5.4.	Paraqitja e jashtme dhe e brendshme (formati, faqosja, madhësia e shkronjave, largësia midis rreshtave etj.) i përshtaten grup-moshës së nxënësve.					

Vlera e standardit 5 = $\{[5.1 + - + 5.4] : 4\} =$



STANDARDI 6: KONCEPTIMI DHE SHITJELLIMI DIDAKTIK

Synimi: Teksti shkollor të ketë konceptim didaktik bashkëkohor që konkretizon kërkesat e qasjeve të reja. Përgatitja, hartimi dhe shitjellimi i njësive/temave mësimore, i situatave të nxënies (ushtrime, detyra etj.) dhe i udhëzimeve të mbështeten në parimet didaktike aktuale, si: të nxënit në mënyrë të pavarur, bashkëpunimi në grup, të nxënit ndërveprues, gjithëpërfshirës dhe reflektues etj. Teksti shkollor të ofrojë situata, materiale dhe sugjerime të përshtatshme për nivele dhe stile të ndryshme të nxënies së nxënësve.

Shënim. Struktura e kuptueshme e tekstit shkollor dhe orientimet e qarta për qëllimet dhe për rezultatet e të nxënit ndihmojnë dhe prindërit të kuptojnë më mirë çka ndodh dhe çka kërkohet në procesin e të nxënit, që dhe ata të jenë në gjendje t'i ndihmojnë më lehtë fëmijët e tyre.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
6.1.	Teksti shkollor është ndërtuar sipas një konceptimi didaktik të qartë dhe koherent të cilin e respekton me përpikëri.					
6.2.	Në tekstin shkollor, temat dhe situatat e të nxënit (shkrimet, detyrat, ushtrimet etj.) janë renditur nga e thjeshta te më e ndërlikuara.					
6.3.	Përmbajtja e tekstit shkollor është ndarë në njësi dhe në hapa pune të përshtatshëm, të qartë e të kuptueshëm për nxënësit.					
6.4.	Teksti shkollor ofron situata të nxëni, detyra, ushtrime dhe sugjerime të qarta që ndihmojnë nxënësit të orientohen me lehtësi, të vendosin synime dhe të vlerësojnë suksesin e arritjeve.					
6.5.	Teksti shkollor, përmes ilustrimeve, grafikëve, shpjegimeve të fjalëve, formulimeve, termave e koncepteve të reja, konkretizon dhe mbështet të nxënit.					
6.6.	Për secilën njësi/temë, teksti shkollor përmban shkrime, materiale, ushtrime dhe detyra në nivele të ndryshme, të kërkesave dhe vështirësisë, të cilat i motivojnë nxënësit në procesin e përvetësimit dhe të transferimit të njohurive.					
6.7.	Përmes materialeve dhe udhëzimeve të përshtatshme, teksti shkollor nxit të nxënit në mënyrë të pavarur si dhe mundëson punën e diferencuar në klasë.					
6.8.	Teksti shkollor ofron mënyra, strategji dhe teknika për zhvillimin e aftësive metakognitive që lidhen me procesin e të nxënit.					



6.9.	Teksti shkollor nxit mendimin kritik dhe krijues të nxënësve, si dhe zhvillon aftësitë e tyre për të zgjidhur probleme dhe për të marrë vendime të argumentuara.					
6.10.	Teksti shkollor ofron tema, shkrime, ushtrime etj. që janë të përshtatshme për të punuar në forma të ndryshme sociale bashkëpunuese, komunikuese dhe ndërvepruese (p.sh.: mësim me të gjithë klasën, punë në çifte, punë në grupe).					
6.11.	Teksti shkollor përmban materiale, sugjerime, detyra etj., të cilat lejojnë shtjellime të temave, sipas nevojave dhe niveleve të ndryshme të nxënies.					
6.12.	Teksti shkollor u shpjegon dhe u qartëson nxënësve qëllimet, kërkesat, rrugët/mënyrat dhe rezultatet e të nxënit, çka ndihmon të orientojnë vetë, të kenë parasysh qëllimet dhe të aftësohen të vetëvlerësojnë rezultatet e nxënies.					

Vlera e standardit 6 = {[6.1 + - + 6.12] : 12} =



STANDARDI 7: PYETJET DHE UDHËZIMET PËR DETYRAT

Synimi: Pyetjet dhe detyrat e paraqitura në tekst, përveç njohurive, të nxisin edhe zhvillimin e shkathtësive, të qëndrimeve dhe vlerave. Pyetjet dhe detyrat të jenë të formuluar thjesht, qartë, shkurt dhe saktë; të jenë të llojeve dhe të niveleve të ndryshme; të nxitin krijimtarinë që nxënësit të jenë aktivë në procesin e të nxënës.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
7.1.	Pyetjet dhe detyrat janë hartuar për nivele të ndryshme njohëse dhe bazohen në situatat që paraqiten në tekst.					
7.2.	Pyetjet dhe detyrat, në aspektin metodologjik, janë të hartuara që t'i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë krijimtarinë e tyre.					
7.3.	Formulimi i pyetjeve dhe i detyrave i ndihmon nxënësit të zhvillojnë të menduarit kritik dhe të pavarur.					
7.4.	Paraqitja e detyrave në tekstin shkollor nxit nxënësit të hulumtojnë.					
7.5.	Detyrat e përzgjedhura në tekstin shkollor mundësojnë punën në grup të nxënësve dhe zhvillojnë kompetencat gjuhësore.					
7.6.	Pyetjet dhe detyrat në tekst janë në përputhje me përmbajtjen mësimore, të përshtatshme për moshën e nxënësve.					

Vlera e standardit 7 = {[7.1 + - + 7.6]: 6} =



STANDARDI 8: ASPEKTET GJUHËSORE

Synimi: Gjuha e tekstit shkollor të jetë në përputhje me normat e gjuhës standarde dhe t'u shërbejë nxënësve si shembull. Aspektet fonetike, leksikore, morfologjike dhe sintaksore, (gjatësia e shkrimeve mësimore), t'u përshtaten aftësive gjuhësore të moshës për të cilën teksti shkollor është përgatitur. Formulimet, sidomos të udhëzimeve, të pyetjeve dhe të detyrave, të jenë të kuptueshme dhe të thjeshta, që të nxitet të nxënit e pavarur të nxënësve. Për të njëjtën temë, teksti të ofrojë shkrime dhe materiale me nivele gjuhësore të ndryshme, duke ndihmuar dhe duke nxitur me këtë të gjithë nxënësit.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
8.1.	Leksiku i përdorur përputhet me moshën e nxënësve, çka e bën gjuhën e tekstit të kuptueshme për ta.					
8.2.	Ndërtimi sintaksor dhe gjuha e shkrimeve të tekstit shkollor përputhen me mundësitë gjuhësore të nxënësve për të cilët është përgatitur teksti.					
8.3.	Gjatësia e shkrimeve u përshtatet moshës dhe aftësive të leximit të nxënësve.					
8.4.	Formulimet, sidomos të detyrave dhe të udhëzimeve për punë të pavarur, janë të kuptueshme dhe të thjeshta, që nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur.					
8.5.	Gjuha e tekstit shkollor, në aspektet fonetike, morfologjike, sintaksore dhe drejtshkrimore, përputhet plotësisht me normat e standardit të gjuhës.					

Vlera e standardit $8 = \{[8.1 + - + 8.5] : 5\} =$



III. ASPEKTET PEDAGOGJIKE (STANDARDET 9 – 12)

STANDARDI 9: LIDHJA ME REALITETET SHOQËRORE, HISTORIKE DHE POLITIKE

Synimi: Teksti shkollor të lidhet me realitetet shoqërore, historike dhe politike shqiptare, t'i shmanget çdo njëanshmërie dhe, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ndihmojë dhe të nxitë mirëkuptimin dhe tolerancën.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
9.1.	Teksti shkollor nxit dashurinë për gjuhën shqipe.					
9.2.	Teksti shkollor pasqyron kontekstet historike të shqiptarëve.					
9.3.	Teksti shkollor pasqyron realitetin pluralist, duke i shërbyer mirëkuptimit, tolerancës dhe bashkëjetesës së qëndrueshme. Teksti shkollor nuk i referohet në mënyrë të njëanshme një grupi ose një individ të veçantë dhe përvojave të tij. Teksti shkollor u referohet shqiptarëve që jetojnë në të gjitha trojet etnike dhe bashkëjetesës me popujt e tjerë.					
9.4.	Në tekstin shkollor, aspektet historike trajtohen në mënyrë objektive dhe pa ngarkesa emocionale.					

Vlera e standardit 9 = $\{[9.1 + - + 9.4] : 4\} =$



STANDARDI 10: EDUKIMI PËR DEMOKRACI DHE PAQE, KOMPETENCA PERSONALE DHE QYTETARE

Synimi: Teksti shkollor të nxitë zhvillimin e nxënësve si qytetarë të pavarur të cilët i marrin vetë vendimet. Teksti shkollor të ndihmojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, edukimin për demokraci dhe për paqe, duke u orientuar drejt vlerave, si: gatishmëria për bashkëpunim dhe marrja e përgjegjësi, kuraja qytetare, integriteti, respektimi i shumëllojshmërive kulturore, etnike etj. Pyetjet dhe detyrat të nxisin dialogun dhe ndërveprimin midis nxënësve.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
10.1.	Teksti shkollor, nëpërmjet pyetjeve dhe detyrave të përshtatshme, ndihmon në edukimin për demokraci dhe për paqe (aftësim për dialog, gatishmëri për bashkëpunim, komunikim, tolerancë, altruizëm e solidaritet njerëzor etj.).					
10.2.	Teksti shkollor ndihmon në zhvillimin e kompetencave personale dhe qytetare.					
10.3.	Teksti shkollor ndihmon zhvillimin e pavarësisë së nxënësve, nëpërmjet shkrimeve, materialeve, pyetjeve, detyrave etj.					

Vlera e standardit 10 = $\{[10.1 + - + 10.3] : 3\} =$



STANDARDI 11: PASQYRIMI I BARAZISË GJINORE

Synimi: Teksti shkollor të kontribuojë në edukimin për barazinë gjinore, të shmangë diskriminimin gjinor. Në shkrime, ilustrime, detyra etj., femrat dhe meshkujt të jenë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë dhe jo sipas stereotipave tradicionale.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
11.1.	Në shkrimet, ilustrimet, detyrat, pyetjet etj., meshkujt dhe femrat janë përfaqësuar në mënyrë të barabartë dhe po aq shpesh, kur e lejon natyra e temës.					
11.2.	Në shkrimet e ilustrimeve, detyrave, pyetjeve etj., teksti shkollor u referohet në mënyrë të barabartë dhe po aq shpesh përvojave dhe interesave të femrave dhe të meshkujve.					
11.3.	Teksti shkollor u shmanget stereotipave gjinorë, në lidhje me ndarjen e roleve dhe të pamjeve të njëanshme, duke treguar dhe duke paraqitur femra dhe meshkuj në veprimtari dhe kontekste të ndryshme.					
11.4.	Të dyja gjinitë portretizohen, pasqyrohen dhe kanë role në mënyrë të barabartë si në jetën private (në familje), ashtu dhe në të gjitha sferat e jetës shoqërore (në sferën publike, në kontekst historik etj.).					

Vlera e standardit 11 = $\{[11.1 + - + 11.4] : 4\} =$



STANDARDI 12: LIDHJA ME ÇËSHTJE TË TJERA PEDAGOGJIKE TË RËNDËSISHME

Synimi: Teksti shkollor të plotësojë kërkesat e edukimit për ruajtjen e mjedisit, edukimit shëndetësor dhe edukimit për media.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
12.1.	Teksti shkollor, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, kultivon ndjenjën e dashurisë ndaj mjedisit dhe përgjegjësinë për ruajtjen e tij.					
12.2.	Teksti shkollor, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ndihmon në edukimin shëndetësor (duke bërë objekt aspekte, si: ushqimi, sporti/lëvizja, higjiena etj.).					
12.3.	Teksti shkollor, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ndihmon për përdorimin e përshtatshëm të mediave dhe për edukimin e qëndrimit të pavarur ndaj tyre (p.sh., duke nxitur nxënësit të bëjnë hulumtime, të krahasojnë burime të ndryshme etj.).					

Vlera e standardit 12 = $\{[12.1 + - + 12.3] : 3\} =$



IV. ASPEKTE TË PRAKTIKËS MËSIMORE (STANDARDET 13–14)

STANDARDI 13: LIBRI I MËSUESIT DHE PËRDORIMI I TIJ

Synimi: Në librin për mësuesin: 1. të shtjellohen në mënyrë të kuptueshme dhe të qartë qëllimet, konceptimi didaktik, struktura/ndërtimi, pikat kyç të tekstit shkollor dhe mënyrat si duhet punuar me të; 2. të paraqiten udhëzime dhe orientime të shkurtra, konkrete, për trajtimin e situatave, shkrimeve, materialeve, ushtrimeve etj., të tekstit shkollor.

Libri i mësuesit t'i ndihmojë mësuesit që të organizojnë dhe të menaxhojnë procesin e mësimdhënies dhe të nxënies me tekstin shkollor.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
13.1.	Libri i mësuesit informon në mënyrë të shkurtër e të qartë për qëllimet, konceptimin didaktik, ndërtimin, pikat kyçe dhe mënyrën si duhet punuar me tekstin shkollor.					
13.2.	Libri i mësuesit jep sugjerime dhe udhëzime konkrete për trajtimin didaktik të secilës temë, faqe, detyrë etj.					
13.3.	Libri i mësuesit përmban udhëzime për planifikimin dhe organizimin e mësimit.					
13.4.	Udhëzimet për përdorimin e librit të mësuesit janë të thjeshta dhe të qarta.					

Vlera e standardit 13 = {[13.1 + - + 13.4] : 4} =



STANDARDI 14: MATERIALET QË SHOQËROJNË TEKSTIN MËSIMOR

Synimi: Teksti shkollor të shoqërohet me materiale pune që ndihmojnë dhe nxitin përvetësimin dhe përdorimin e njohurive të reja dhe të kompetencave. Materialet e punës mund të jenë: a) të integruara në tekstin shkollor (p.sh., në formën e udhëzimeve, të detyrave dhe të ushtrimeve); b) të veçanta (p.sh., fletore pune që shoqëron tekstin shkollor, CD, linqe të faqeve të internetit etj.). Ato të jenë të larmishme, të shumëllojshme dhe motivuese, të përshtaten për nivele të ndryshme intelektuale të nxënësve.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
14.1.	Materialet e punës përshtaten dhe plotësojnë tekstin shkollor. Teksti shkollor shoqërohet me mjete dhe referenca të tjera të mjaftueshme mbështetëse multi/hipermediale (CD, DVD, software etj.), përfshirë edhe mundësinë e bashkëveprimit me portalet përkatëse aktive virtuale.					
14.2.	Materialet e punës i shërbejnë përpunimit, përvetësimit dhe zbatimit efektiv të përmbajtjes së tekstit shkollor.					
14.3.	Nga ana metodike, materialet e punës janë të larmishme dhe të shumëllojshme. Ato janë të përshtatshme për punën e diferencuar me nxënësit.					
14.4.	Fletoret e punës dhe materialet e tjera plotësuese janë pjesë integrale e tekstit shkollor sipas qasjes së integruar të kurrikulës.					

Vlera e standardit 14 = {[14.1 + - + 14.4] : 4} =



STANDARDI PLOTËSUES LËNDOR

V. ASPEKTI PLOTËSUES

Standardi nr. 15 Abetare

STANDARDI 15: STANDARDI PLOTËSUES PËR TEKSTIN SHKOLLOR TË VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE”

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.1.	Abetarja siguron (edhe përmes udhëzimeve për mësuesin) që fëmijët të kuptojnë, që në fillim të vitit shkollor, natyrën (strukturën, ndërtimin), funksionet dhe mundësitë e shkrimit dhe të teknikave të shkrimit dhe të leximit, si dhe shmang rrezikun e nxënies mekanike të shkrimit të shkronjave.					
15.2.	Rendi sipas të cilit mësohen shkronjat dhe ndërlidhjet midis fonemave dhe grafemave, është i arsyeshëm (p.sh., shpeshtësia e shkronjave në alfabet).					
15.3.	Leksiku përfshin fjalë të thjeshta dhe që janë pjesë e fjalorit të përditshëm (ose të zakonshëm) të fëmijëve.					
15.4.	Abetarja respekton veçoritë gjuhësore të gjuhës shqipe dhe ndikon, me kujdes dhe sistematikisht, që nxënësit të njihen me gjuhën standarde (standardi 8).					
15.5.	Abetarja merr parasysh vështirësitë e alfabetizimit (p.sh., probleme/ngatërrime të fonemave të ngjashme, si ç, q, gj, xh, në gjuhën shqipe dhe të grafemave të ngjashme, si b – d, p-q, probleme të lidhjes së shkronjave gjatë leximit etj.) dhe ka kujdes të veçantë për të zhvilluar aftësitë e të lexuarit te nxënësit.					
15.6.	Për të lehtësuar dhe për të nxitur procesin e leximit, shkrimet, të paktën në dy të tretat e para të abetares, jepen jo në rreshta të zakonshëm, por ndahen që secili rresht të përmbajë vetëm një njësi sintaksore apo kuptimore (fjali).					
15.7.	Abetarja përdor madhësi (font size) shkronjash që lexohen lehtë, që janë të përshtatshme për moshën dhe, veçanërisht në fillim, shkronja mjaft të mëdha.					
15.8.	Largësia mes rreshtave është mjaft e madhe që faqet të jenë të qarta e të kapshme dhe të lehtësohet orientimi i nxënësve në tekst.					
15.9.	Për të ndihmuar zhvillimin gjuhësor të nxënësve, sidomos për fazën fillestare, abetarja ofron shumë fotografi, piktura etj., dhe sugjerime përkatëse me karakter motivues për biseda e komunikim gojor.					



15.10.	Abetarja nxit punën e pavarur të nxënësve, p.sh., përmes një numri të caktuar të piktogrameve në lidhje me udhëzime dhe detyra (p.sh., shenja □ për foljen shkruaj) dhe me paraqitje tepër të kuptueshme të ushtrimeve.					
15.11.	Abetarja përmban situata të nxëni (detyra/ushtrime shtesë për nxënës të niveleve të ndryshme).					
15.12.	Abetarja ka parasysh që premiset dhe njohuritë paraprake të nxënësve në lexim-shkrim, në fillim të klasës së parë, ndryshojnë shumë; për këtë, abetarja ofron ndihmë dhe materiale për dallimet mes nxënësve dhe individualizimin e të nxënit (p.sh., një tabelë me të gjitha shkronjat si mbështetje e të nxënit në mënyrë të pavarur).					
15.13.	Që në fillim, kompetenca e leximit dhe e shkrimit ushtrohet në mënyrë intensive dhe efektive, përmes situatave të larmishme dhe motivuese për mësim e përsëritje sistematike të grafemave (të ndërlidhjeve midis fonemave dhe grafemave) të mësuara.					
15.14.	Abetarja ndihmon aftësitë e dekodimit, rrjedhshmërisë dhe të kuptuarit. Këtij qëllimi (d.m.th. nxënësit edhe të mendojnë për atë që kanë lexuar) i shërbejnë shmangia e teksteve të pakuptueshme, përdorimi i fjalive korrekte nga ana sintaksore (të plotësuara me simbole apo piktura për fjalë që ende s'mund të lexohen), si dhe udhëzimet dhe pyetjet përkatëse.					
15.15.	Abetarja kontribuon, përmes një vargu sugjerimesh dhe detyrash konkrete dhe të përshtatshme për moshën, për zhvillimin e ndërgjegjes gjuhësore dhe të aftësive reflektuese lidhur me gjuhën.					
15.16.	Abetarja, në materialin për nxënësit dhe në librin për mësuesin, përmban orientime dhe ushtrime të mjaftueshme për zhvillimin e kompetencave të leximit dhe të shkrimit (përfshirë aspektet motorike të shkrimit).					
15.17.	Në librin e mësuesit përfshihen elemente të rëndësishme, si: zhvillimi i ndërgjegjes fonologjike, zhvillimi i hershëm i kompetencës për komunikim dhe shprehje etj.					

Vlera e standardit 15.1 = {[15.1. + - + 15.17] : 17} = ____



FORMULARI PËRMBLEDHËS

Titulli:	Kodi:	
	Data e recensimit:	
Standardi		Vlera
STANDARDET E PËRGJITHSHME		
Përputhshmëria me kurrikulën, formatimi, paraqitja (Standardet 1 – 3)		
1.	Përputhshmëria me kurrikulën	
2.	Paraqitja dhe qartësia	
3.	Ilustrimet	
Aspektet shkencore dhe didaktike (Standardet 4 – 8)		
4.	Cilësia, rëndësia dhe aktualiteti në pikëpamje përmbajtësore dhe shkencore	
5.	Përshtatja me moshën e nxënësve	
6.	Konceptimi dhe shtjellimi didaktik	
7.	Pyetjet dhe udhëzimet për detyrat	
8.	Aspektet gjuhësore	
Aspektet pedagogjike (Standardet 9 – 12)		
9.	Lidhja me realitetet shoqërore, historike dhe politike	
10.	Edukimi për demokraci dhe paqe, kompetenca personale dhe qytetare	
11.	Pasqyrimi i barazisë gjinore	
12.	Lidhja me çështje të tjera pedagogjike të rëndësishme	
Aspekte të praktikës mësimore (Standardet 13 – 14)		
13.	Libri i mësuesit dhe përdorimi i tij	
14.	Materialet që shoqërojnë tekstin shkollor	
	STANDARDI PLOTËSUES LËNDOR (Standardi 15)	
15	Standardi plotësues për tekstin shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”	
VLERA E TEKSTIT		



**III. KORNIZA E PËRBASHKËT E PROGRAMEVE TË
GJUHËS SHQIPE PËR TEKSTIN E VETËM TË
PËRBASHKËT “ABETARE”**

Hyrje

Në bazë të dokumentit “Program bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës për procedurat e organizimit të konkursit për tekstin e vetëm të përbashkët të abetares” është hartuar Korniza e përbashkët e programeve të gjuhës shqipe për Abetaren. Kjo kornizë është e bazuar në programet mësimore/kurrikulat lëndore “Gjuhë shqipe” për klasën e parë të të dyja vendeve. Korniza përmban qëllimin, rezultatet e të nxënit të lëndës, si dhe disa udhëzime të përgjithshme për metodologjinë.

Qëllimi

Korniza e përbashkët e programeve të gjuhës shqipe për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare” ka për qëllim paraqitjen e elementeve të përbashkëta të programeve të lëndës së gjuhës shqipe për klasën e parë në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës, për të orientuar shtëpitë botuese/autorët dhe recensentët që do të përfshihen në hartimin dhe në vlerësimin e tekstit të vetëm të përbashkët të abetares.

Qëllimet e lëndës së gjuhës shqipe

Qëllimet e lëndës së gjuhës shqipe janë:

- Zhvillimi i aftësive/shkathtësive për të dëgjuarit dhe për të folurit në situata të ndryshme dhe për tema të përshtatshme për moshën e nxënësve.
- Zhvillimi i aftësive/shkathtësive për të lexuarit dhe për të shkruarit fillestar dhe të kuptimshëm.
- Pasurimi i fjalorit të nxënësve dhe përdorimi i drejtë i fjalëve të reja gjatë komunikimit.
- Përdorimi i njohurive elementare të sistemit gjuhësor të shqipes dhe zbatimi i rregullave kryesore të drejtshkrimit dhe të drejtshqiptimit.
- Zhvillimi i botës emocionale dhe i imagjinatës së nxënësve.
- Formimi kulturor dhe kombëtar i nxënësve.

Rezultatet e të nxënit të lëndës

Të dëgjuarit dhe të folurit

Nxënësi:

- tregon njohuritë paraprake për tekstin që dëgjon;
- u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit që dëgjon;
- tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit (tekst rreth gjysmë faqeje) duke e ilustruar me detaje nga teksti;
- shpreh dhe argumenton me gjuhë të thjeshtë pëlqimet dhe emocionet e tij rreth ngjarjeve dhe personazheve të tekstit që dëgjon;
- demonstroi sjellje të përshtatshme gjatë të dëgjuarit, si p.sh.: ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon, nuk e ndërpret tjetrin, kur është duke folur, e sheh në sy personin gjatë kohës që flet;
- shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë;
- shprehet saktë dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, pyet, sqaron, kërkon ndjesë, falënderon dhe u përgjigjet pyetjeve;
- rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve;



- diskuton për tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tij, si: pëlqimet dhe interesat e fëmijëve, familja, shokët dhe shoqet, lojërat, pushimet, rrezikun nga dukuritë natyrore etj.;
- reciton me ndjenjë vjersha/poezi të shkurtra;
- përshkruan ose rrëfen mbi bazën e ilustrimeve dhe figurave të dhëna;
- merr pjesë në lojë me role dhe shpreh opinionet e tij rreth interpretimit të shokëve dhe të shoqeve të klasës;
- diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë (kryesisht brenda klasës).

Të lexuarit

Nxënësi:

- identifikon dhe lexon drejt shkronjat, zanoret dhe bashkëtingëlloret;
- dallon shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla gjatë leximit;
- shqipton drejt tingujt/shkronjat, rrokjet, fjalët dhe fjalitë;
- dallon rrokjen/t në fjalë;
- lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekste të ndryshme;
- flet rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli dhe tek ilustrimet;
- dallon pjesët e shkruara nga pjesët e ilustruara në një tekst;
- pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të;
- tregon shkurtime dhe me fjalë të thjeshta brendinë;
- përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet;
- tregon dhe argumenton se cilat janë personazhet që i pëlqejnë;
- lidh tekstin që lexon me përvojat e tij të mëparshme;
- shpreh përjetimet emocionale dhe ndjenjat për tekstin që lexon;
- dallon elemente të tekstit letrar, të tilla si: titulli, rreshti, strofa, vargu etj.;
- dallon tiparet kryesore të poezisë dhe të prozës;
- dallon tiparet kryesore të përrallës (p.sh.: fillon me “na ishte një herë”, ka fund të lumtur), fabulës, tregimeve të shkurtra, gjëegjëzave, fjalëve të urta;
- lexon dhe dallon tekste jo letrare, si: kartolina, urime, kalendarë, informacione për fëmijë etj.

Të shkruarit

Nxënësi:

- shkruan shkronjat e gjuhës shqipe;
- tregon me saktësi lidhjen tingull-shkronjë;
- respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive;
- plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve ose fjalive;
- shkruan fjalë deri me 3 rrokje;
- kopjon tekste deri në 3-4 fjali;
- shkruan fjalë dhe fjali me të diktuar;
- u përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta;
- përdor modele të gatshme të punëve me shkrim (p.sh.: modele kartolinash, urimesh);
- shkruan deri në 4 fjali për tema të përshtatshme për moshën e tij;
- bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit.
- shkruan tregime të thjeshta nisur nga figurat e dhëna;
- përshkruan (deri në 3 fjali), se si e kupton një pikturë, një pamje apo një fotografi;



- përshkruan (me 2-3 fjalë/fjali) shokë, miq, të afërm, personazhe, sende e kafshë të dashura për të;
- shkruan tekste të shkurtra (një urim, një kartolinë, një letër drejtuar një shoku etj.) duke u mbështetur në një model të dhënë.

Sistemi gjuhësor

Nxënësi:

- dallon dhe përdor fjalë që tregojnë njerëz, kafshë dhe sende (emra);
- dallon me intuitë kur emrat janë në njëjës dhe në shumës (një-disa, shumë);
- dallon dhe përdor fjalët që tregojnë cilësi (mbiemrat);
- dallon dhe përdor fjalët që zëvendësojnë emrat (përemrat vetorë);
- dallon dhe përdor fjalët që tregojnë veprime (foljet);
- përdor foljet kam dhe jam në kohën e tashme (tani, sot), në kohën e shkuar (dikur, dje) dhe në kohën e ardhme (nesër...);
- dallon fjalitë në një tekst, bazuar në shkronjën e madhe në fillim dhe shenjën e pikësimit në fund;
- dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore dhe pyetëse, duke respektuar shenjat e pikësimit;
- dallon dhe formon fjali pohore dhe mohore;
- zhvendos fjalët në një fjali, në mënyrë të tillë që të mos priset kuptimi i saj;
- shton dhe heq fjalë në një fjali të thjeshtë, pa prishur kuptimin e saj;
- përdor drejt pikën dhe pikëpyetjen në fund të fjalisë;
- përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë;
- përdor drejt shkronjën e madhe për emra të përveçëm njerëzish, vendesh dhe kafshësh;
- dallon dhe gjen fjalë që kanë kuptim të përafërt ose të njëjtë me fjalët e dhëna (sinonimet);
- dallon dhe gjen fjalë që kanë kuptim të kundërt me fjalët e dhëna (antonimet).

Udhëzime metodologjike

Teksti i abetares së përbashkët është mjet/burim të nxëni që duhet të promovojë qasjet e reja pedagogjike. Abetarja do të jetë në funksion të zhvillimit të kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës. Teksti i abetares duhet të reflektojë zhvillimet didaktiko-metodike, ndryshimet shoqërore dhe teknologjike.

Në tekst zë vend kryesor përmbajtja lëndore dhe rezultatet e të nxënit. Teksti u përshtatet nevojave dhe interesave të nxënësve dhe ofron strategji efektive të nxënies. Teksti mundëson që nxënësit të mësojnë konceptet/përmbajtjen për sistemin gjuhësor nëpërmjet teksteve të ndryshme letrare e jo letrare (të integruara) dhe të zhvillojnë shkathtësitë e komunikimit.

Teksti i përshtatet heterogjenitetit të nxënësve të klasës së parë.

Shënim. Shtëpitë botuese/autorët përveç kësaj Kornize t`u referohen edhe dokumenteve të tjera kurrikulare të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, si dhe standardeve për tekstin shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”.

KLIKO KËTU për programin e Gjuhës shqipe, arsimit fillor (klasor), klasa e parë, të Republikës së Shqipërisë.

KLIKO KËTU për programin e Gjuhës shqipe, arsimit fillor (klasor), klasa e parë, të Republikës së Kosovës.



IV. KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E RECENSUESVE



Recensent është specialisti/eksperti i zgjedhur nga Komisioni i përbashkët për organizimin e konkursit për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare”, përgjegjës për vlerësimin profesional të tekstit shkollor në dorëshkrim.

Vlerësimi i tekstit shkollor në dorëshkrim bëhet nga recensentë, me numër të barabartë nga të dyja vendeve, prej të cilëve:

- dy specialistë/pedagogë të gjuhës shqipe;
- dy specialistë/pedagogë të letërsisë;
- katër mësues të arsimit fillor;
- dy redaktorë gjuhësorë.

Kriteret për përzgjedhjen e recensentëve:

Specialisti/pedagogu:

- Të ketë gradë shkencore ose titull akademik, në gjuhë shqipe dhe/ose letërsi.
- Të ketë kontribute në fushën përkatëse (botime, konferenca).
- Përparësi kanë kandidatët me përvojë në vlerësimin e teksteve shkollore.

Mësuesi/mësimdhënësi i arsimit fillor:

- Të jetë i diplomuar si mësues/mësimdhënësi për arsimin fillor/klasor.
- Të jetë mësues në arsimin fillor në Shqipëri ose në Kosovë.
- Të ketë përvojë pune mbi 10 vjet si mësues i arsimit fillor/klasor.
- Të ketë kualifikime dhe trajnime në fushën e mësimdhënies.
- Përparësi kanë kandidatët me përvojë në vlerësimin e teksteve shkollore.

Redaktori gjuhësor:

- Të jetë i diplomuar në ciklin e dytë të studimeve në gjuhë shqipe.
- Të ketë përvojë në redaktimin gjuhësor në fushën e botimeve.
- Përparësi kanë kandidatët me përvojë në vlerësimin e teksteve shkollore.

